



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 111 Prot.

Tiranë, më 12 . 1 .2026

U R D H Ë R

Nr. 15 , datë 12 . 1 .2026

**“PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2026
NË INSTITUCIONIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS”**

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si dhe vendimit të Presidentit të Republikës nr. 5, datë 29.7.2025, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Planit Vjetor të Pranimit në Institucionin e Presidentit të Republikës me numër total 12 vende vakante, të planifikuara për rekrutim në shërbimin civil, në administratën e Institucionit të Presidentit të Republikës, për vitin 2026.

Vendet vakante ndahen si më poshtë:

- Nëpunës civil në kategorinë e mesme drejtuese – 3 vende;
- Nëpunës civil në kategorinë e ulët drejtuese – 2 vende;
- Nëpunës civil në kategorinë ekzekutive – 7 vende.

Për formimin dhe fushat e studimit të individëve që do të rekrutohen, nuk do të ketë kufizime të ngushta, por kryesisht do të preferohen drejtimet:

- Shkenca Juridike;
- Shkenca Politike dhe të Administrimit;
- Shkenca Shoqërore dhe Komunikimi;
- Shkenca Inxhinieri Informatike;
- Shkenca të tjera të përshtatshme me detyrat dhe funksionet institucionale.

Procedurat e plotësimit të vendeve vakante në Institucionin e Presidentit të Republikës do të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, si dhe me rregullat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Njoftimet për vendet vakante do të publikohen rast pas rasti në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës www.president.al dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Rekrutimi dhe emërimi i nëpunësve civilë, do të bëhet në varësi të strukturës së miratuar me vendimin e Presidentit të Republikës nr. 5, datë 29.7.2025, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institucionit të Presidentit të Republikës”, si dhe të nevojave konkrete për realizimin e misionit, funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Institucionit të Presidentit të Republikës.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Lusha
Valbona Lusha

